

VENDIM
Nr. 507, datë 1.8.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, FAZA V, FSHATI MBYET, NJËSIA ADMINISTRATIVE PORTËZ, BASHKIA FIER”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike, faza V, fshati Mbyet, Njësia Administrative Portëz, Bashkia Fier”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Fier.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 12 933 420 (dymbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e njëzet) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 12 933 420 (dymbëdhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e njëzet) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Fier.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Fier.

8. Bashkia Fier kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Fier.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Fier, për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Fier, për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Fier, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA E SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, FAZA V, FSHATI MBYET, NJËSIA ADMINISTRATIVE PORTËZ, BASHKIA FIER”

Nr.	Emër, atësi, mbiemër	Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)				Vlerësimi për shpronësim							Vlera totale	Shënime
		ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. e tokës “arë” total (m ²)	Sip. e tokës “arë” që preket (m ²)	Sip. e tokës “truall” që preket (m ²)	Çmimi i tokës “arë” lek/m ²	Çmimi i tokës “truall” lek/m ²	Vlera e tokës “arë”	Vlera e tokës “truall”	Vlera e drufrutorëve të mbjellë		
1	Veli Selim Tahiri	2637	288/32	Arë	2850	2850		269		766,650	-		766,650	Konfirmuar nga ASHK-ja, i papajisur me certifikatë pronësie.
2	Shefqet Selim Tahiri	2637	288/36	Arë	1088	1088		269		292,672	-	389,276	681,948	Konfirmuar nga ASHK-ja, i papajisur me certifikatë pronësie.
3	Mysafer Maliq Hoxhaj Niazie Novruz Hoxhaj	2637	288/125	Arë	3065	3065		269		824,485	-	976,705	1,801,190	Konfirmuar nga ASHK-ja me certifikatë pronësie.
4	Mynyr Mehmet Aliaj	2637	288/112	Arë	1500	1500		269		403,500	-	475,880	879,380	Konfirmuar nga ASHK-ja me certifikatë pronësie.
5	Laver Hekuran Hoxhaj	2637	288/38	Arë	4000	4000		269		1,076,000	-	1,382,900	2,458,900	Konfirmuar nga ASHK-ja me certifikatë pronësie.
6	Osmen Ibrahim Hoxha	2637	288/46	Arë	1755	1755		269		472,095	-	210,420	682,515	Konfirmuar nga ASHK-ja, i papajisur me certifikatë pronësie.
7	Barjam Maliq Hoxha	2637	288/47	Arë	1989	1989		269		535,041	-	228,810	763,851	Konfirmuar nga ASHK-ja, i papajisur me certifikatë pronësie.
8	Maliq Ibrush Hoxha	2637	288/48	Arë	1142	1142		269		307,198	-		307,198	Konfirmuar nga ASHK-ja, i papajisur me certifikatë pronësie.
9	Neim Ferik Tahiri	2637	288/49	Arë	8372	8372		269		2,252,068	-	2,339,720	4,591,788	Konfirmuar nga ASHK-ja, i papajisur me certifikatë pronësie.
Vlera totale										6,929,709	-	6,003,711	12,933,420	